VENDIM
Nr.353, datë 4.5.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QAFË-KASHAR-RINAS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë-Kashar-Rinas.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 2407 (dy mijë e katërqind e shtatë) m^2 tokë arë me vlerë 1 384 025 (një milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëzet e pesë) lekë, për objekt me sipërfaqe 49.5 (dyzet e nëntë pikë pesë) m^2 me vlerë 997 841 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për tokë arë dhe objekt, është 2 381 866 (dy milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 291 000 (dyqind e nëntëdhjetë e një mijë) lekë do të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për tokë arë dhe objekt, është 2 381 866 (dy milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, e cila do të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 15.5.2011 dhe të përfundojë më 15.8.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhen këtij vendimi, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë të rifreskuar brenda afateve ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 6 dhe 7, të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, pasi të ketë marrë konfirmimin pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen: procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha